

Emertimi dhe Forma Ligjore

"BOMIRA" SHPK

Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar

NIPT-I

K02701016D

Adresa e Selise

Ure Vajgurore

Data e krijimit

23.03.1999

Nr. i Rregjistrimit Tregtar

21093

Veprimtaria kryesore

**Tregti me shumice e pakice mallra
ushqimor dhe prodhim ambalazhe
plastike.**

PASQYRAT FINANCIARE

Viti 2012

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga 01.01.2012 Deri 31.12.2012

DATA E MBYLLJES SE PASQYRAVE FINANCIARE 25.03.2013

PASQYRAT FINANCIARE JANE INDIVIDUALE INDIVIDUALE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE KONSOLIDUARA _____

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE SHPREHURA NE LEKE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE RRUMBULLAKOSURA NE 0 LEKE

“BOMIRA” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e bilancit kontabel me 31.12.2012

ZERI I BILANCIT		She nime	Viti ushtrimor 2012	Viti paraardhes 2011
A	AKTIVET			
I	Aktivët Afatshkurtëra			
1	Mjete monetare			
2	Derivative dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim	3	5,238,123	44,386,601
(i)	-Derivatet		0	
(ii)	-Aktivët e mbajtura për tregtim		0	0
	Totali 2		0	0
3	Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
(i)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme			
(ii)	Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	4	23,016,450	7,751,539
(iii)	Instrumente të tjera borxhi	5	5,108,813	985,182
(iv)	Investime të tjera financiare		0	0
	Totali 3		0	0
4	Inventari		28,125,263	8,736,722
(i)	Lëndët e para			
(ii)	Prodhim në proces	6	8,088,163	1,947,839
(iii)	Produkte të gatshme	6	28,252,788	35,240,890
(iv)	Mallra për rishitje	6	20,375,339	34,596,130
(v)	Parapagesat për furnizime	6	111,287,585	57,950,624
	Totali 4	6	7,930,252	14,913,229
5	Aktivët biologjike afatshkurtra		175,934,127	144,648,712
6	Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje		0	0
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		0	0
	Totali i aktiveve afatshkurtera (I)		209,297,513	197,772,034
II	Aktivët afatgjata			
1	Investimet financiare afatgjata		0	0
(i)	Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara		0	0
(ii)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje		0	0
(iii)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë		0	0
(iv)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme afatgjata		0	0
	Totali 1.		0	0
2	Aktive afatgjata materiale		0	0
(i)	Toka		0	0
(ii)	Ndërtesa		0	0
(iii)	Makineri dhe pajisje	7	4,218,754	4,304,851
(iv)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	7	79,507,132	84,158,239
	Totali 2	7	1,759,158	1,076,376
3	Aktivët Biologjike afatgjata		85,485,045	89,539,466
4	Aktivët afatgjata jomateriale		0	0
(i)	Emn i mire		0	0
(ii)	Shpenzimet e zhvillimit		0	0
(iii)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale		0	0
	Totali 4		0	0
5	Kapital aksionar i papaguar		0	0
6	Aktive të tjera afatgjata		0	0
	Totali i aktiveve Afatgjata (II)		85,485,045	89,539,466
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		294,782,558	287,311,501

“BOMIRA” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

I	Detyrimet Afatshkurtëra			
1	Derivativët			0
2	Huamarrjet			0
(i)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra		0	0
(ii)	Kthimet/npagesat e huave afatgjata		0	0
(iii)	Bono të konvertueshme		0	0
	Totali 2		0	0
3	Huat dhe parapagimet			
(i)	Të pagueshme ndaj furnitorëve	9	57,243,912	36,435,036
(ii)	Të pagueshme ndaj punonjësve		0	0
(iii)	Detyrime tatimore	9	1,937,762	1,944,148
(iv)	Hua të tjera	9	0	7,912,431
(v)	Parapagimet e arkëtuara	9	0	25,646,612
	Totali 3		59,181,675	71,938,228
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra			0
5	Provizionet afatshkurtra			0
	Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		59,181,675	71,938,228
II	Detyrime afatgjata			
1	Huat afatgjata			
(i)	Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare		0	0
(ii)	Bonot e konvertueshme		0	0
	Totali 1		0	0
2	Huamarrje të tjera afatgjata	10	0	0
3	Provizionet afatgjata		0	0
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		0	0
	Totali i detyrimeve afatgjata (II)		0	0
	Totali i detyrimeve (I+II)		59,181,675	71,938,228
III	Kapitali			
1	Aksionet e pakicës			0
	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë			
2	mëmë		0	0
3	Kapitali aksionar	11	212,873,000	176,603,000
4	Primi i aksionit		0	0
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		0	0
6	Rezerva statusore		0	0
7	Rezerva ligjore	11	2,499,049	2,499,049
8	Rezerva të tjera	11	1,224	321
9	Fitimet e pashpërndara		0	0
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar	12	20,227,610	36,270,903
	Totali i kapitalit (III)		235,600,883	215,373,273
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)		294,782,558	287,311,501

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-16

“BOMIRA” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të Periudhës 1 Janar 2012 deri më 31 Dhjetor 2012

(Bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres)

		Shëni me	Viti ushtrimor 2012	Viti paraardhes 2011
1	Shitjet neto			
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	12,1	696,335,678	772,687,975
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimin në proces	12,2	11,897,684	556,626
4	Materialet e konsumuara		(21,208,893)	42,061,159
5	Kosto e punes	12,3	(620,063,592)	(724,443,201)
	Pagat	12,5	(13,934,516)	(12,341,356)
	Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetsore		(11,940,459)	(10,457,806)
6	Amortizimi dhe zhvleresimet		(1,994,057)	(1,883,550)
7	Shpenzime te tjera	7	(3,400,376)	(5,935,850)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4-7)	12,4	(27,844,310)	(29,917,239)
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/3-8)		21,781,675	42,668,114
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		0	0
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		0	0
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	12,6	0	0
12,1	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		0	0
12,2	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi		(1,448,968)	(2,826,639)
12,3	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi		2,492,202	956,150
12,4	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		0	0
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)		1,043,234	(1,870,489)
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9+10+11+12+/-13)		22,824,909	40,797,624
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	12,7	2,597,299	4,526,722
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)		20,227,610	36,270,903
17	Elementet e pasqyrave te konsoliduara			

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-16

“BOMIRA” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e Fluksit monetar për Periudhën 1 Janar 2012 deri më 31 Dhjetor 2012

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	She nime	Viti ushtrimor 2012	Viti paraardhes 2011
Fluksi i monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit	11.7	22,824,909	40,797,625
<i>Rregullime për:</i>		190,678	8,547,216
Amortizimin	7	3,400,376	5,935,850
Humbje nga kembimet valutore		0	
Të ardhura nga investimet	12.2	(4,660,821)	(241,009)
Shpenzime per interesa	12.6	1,451,123	2,852,376
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti si dhe e kërkesave të tjera		(17,459,120)	26,704,659
		0	
Rritje/renie në tepricën e inventarit		(31,285,415)	(6,482,934)
Rritje/renie në tepricën e detyrimeve për të paguar nga aktiviteti		(12,756,553)	15,589,351
Mjetet monetare të perfituara nga aktivitetet		(38,485,501)	85,155,917
Interesi i paguar		(1,451,123)	(2,852,376)
Tatimitimi i paguar	11.7	(4,526,720)	(4,526,722)
<u>Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit</u>		(44,463,345)	77,776,819
Fluksi monetar nga veprimtaritë Investuese			
Blerje e shoqërisë së kontrolluar _____ minus parate e arketuara			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	7	(6,011,594)	(36,615,308)
Të ardhura nga shitja e paisjeve	12.2	11,326,461	529,427
Interesi i arketuar		0	0
Dividendet e arketuar		0	0
<u>Mjete monetare neto e perdorur në aktivitetet investuese</u>		5,314,867	(36,085,881)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner		0	0
Të ardhura nga huamarrje afatgjata		0	0
Pagesa e detyrimeve të qirase financiare		0	0
Dividendet e paguar		0	0
<u>Mjete monetare neto e perdorur në aktivitetet financiare</u>		0	0
		0	0
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		(39,148,478)	41,690,937
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		44,386,601	2,695,663
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		5,238,123	44,386,601

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-16

“BOMIRA” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e ndryshimeve të Kapitalit gjatë Periudhës 1 Janar 2012 deri më 31 Dhjetor 2012

ne një pasqyre te pakonsoliduar

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione te thesarit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2010	92,318,000	-	-	43,793,839	42,990,531	179,102,370
Efekti ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-	-	-	-	-
Pozicioni I rregulluar	92,318,000	-	-	43,793,839	42,990,531	179,102,370
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	36,270,903	36,270,903
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	84,285,000	-	-	(41,294,469)	(42,990,531)	-
Emetimi i aksioneve(pjeseve te reja te kapitalit)	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2011	176,603,000	-	-	2,499,370	36,270,903	215,373,273
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	20,227,610	20,227,610
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit aksionar (pjeseve te reja)	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	36,270,000	-	-	903	(36,270,903)	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2012	212,873,000	-	-	2,500,273	20,227,610	235,600,883

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-16

"BOMIRA" SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2012

1. Informacione te pergjitheshme

"Bomira" sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me vendim te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane nr.21093 date 23.09.1999 dhe gjendet e regjistruar ne regjistrin tregtar(QKR), identifikuar me NIPT K02701016D. Kapitali i regjistruar eshte 176.603.000 leke dhe zoterohet nga ortaku i vetem z.Ylli Aliaj.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2012 eshte tregtia me shumice e pakice e mallrave ushqimore dhe prodhimi dhe tregtimi i ambalazheve plastike.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë, banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shumën e njohura të mjeteve monetare dhe të cilat nuk janë objekt i një rreziku domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare. Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitetet të tjera të cilat nuk janë aktivitetet investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njesia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim, si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim përjashtohen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

Aktivitetet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivitetet financiare në Llogari/Kërkesa të arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme. Drejtimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivitetet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto, pakesuar nga zhvlerësimi nëse ka.

"BOMIRA" SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njesisë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur ekzistojnë rrethana që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme, vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, moskryerja apo vonesat në pagesa etj. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "Të tjera të ardhura (shpenzime) financiare". Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e koston historike dhe nuk rivlerësohen. Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2012 janë 1 euro=139.59 leke dhe 1 dollar=105.85 leke.

Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK-4 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra për ti sjelle inventaret në kushte magazinimi, kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri.

Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti).

Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të voglën midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuara të shitjes.

Aktivitet afatgjatë materiale

Aktivitet afatgjatë materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin e veta në zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

"BOMIRA" SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndertesa 5 % dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur

Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në përcaktimet e SKK-2. Huamarrjet afatshkurtra njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas. Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, përveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël. Llogaritë të pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrimet e tjera tregtare, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar. Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi në datën e hartimit të pasqyrave financiare.

Huatë afatgjata vlerësohen në hyrje me koston dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabël. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2012 është 10 % aq sa ka qene në ushtrimin e mëparshëm. Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK-11 për tatimin e shtyrë.

3. Aktive monetare (likujditete në banke dhe arke)

Gjendjet e mjeteve monetare, në leke dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2012 dhe 31 Dhjetor 2011 janë si më poshte:

"BOMIRA" SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehën në lekë

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2012		Gjendja ne 31.12.2011	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	leke	4,838,548		43,804,001	
Arka	leke	399,574		582,600	
Shuma Mjete monetare		5,238,123	x	44,386,601	x

Gjendjet e llogarive te mjeteve monetare te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare te bankave perkatese dhe inventaret fizike. Tepricat e shprehura ne monedhe te huaj jane perkthyer ne leke me kursin e dates 31.12.2012 te shpallur nga Banka e Shqiperise. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në valutë të huaj janë sistemuar në rezultatin financiar. Nuk ka ndryshime në politikat kontabël të njohjes, vlerësimit dhe të konvertimit të veprimeve dhe gjendjeve të likuiditeteve ne PF-te 2012.

4. **Aktive te tjera financiare afatshkurtera-Llogari/Kerkesa te arketueshme**

Llogari/Kerkesa te arketushme jane te perbera si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Kliente per mallra, produkte e sherbime	23,016,450	7,873,542
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per mallra, prod.e sherb	0	0
Kliente per aktive afatgjata		
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per aktive afatgjata		
Shuma Kerkesa te arketueshme	23,016,450	7,873,542

"Kliente per mallra produkte e sherbime" pasqyrojne vleren e faturave te pa likujduara ne fund te ushtrimit. Transaksionet pasqyrohen ne llogarite e klienteve me shumate e dokumentuara dhe i perkasin ushtrimit kontabel 2012. Drejtimi vlereson se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

5. **Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme**

Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme jane te perbera si vijon :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Shteti per tatime dhe taksa		
Shteti-Tatim mbi fitimin (teprica debitore)	2,346,827	863,179
Shteti-TVSH per tu marre	2,702,413	0
Shteti -Tatime te tjera (teprica debitore)	59,572	122,003
Personeli (teprica debitore)	0	0
Shuma	5,108,813	985,182

Shumat e paraqitura ne "Llogari/Kerkesa të tjera të arkëtueshme" perfaqesojne tepricen debitore te "Shteti-tatim mbi fitimin" per 2.346.827 leke, TVSH 2.702.413 leke dhe kerkesa te tjera per tu arketuar ne shumen 59.572 leke, per te cilat nuk parashikohet renie ne vlere.

"BOMIRA" SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

6. Inventari

Inventari është i përbërë si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Lende te para		
Materiale te para dhe materiale te tjera	8,088,163	1,947,839
Inventari i imet dhe ambalazhi (afatshkurter)	0	0
Shuma Lende te Para	8,088,163	1,947,839
Prodhim ne Proçes		
Prodhim ne proçes	28,252,788	35,240,890
Punime ne proçes	0	0
Sherbime ne proçes	0	0
Shuma Prodhim ne Proçes	28,252,788	35,240,890
Produkte te Gateshme	20,375,339	34,596,130
Mallra per Rishitje	111,287,585	57,950,624
Parapagime per furnizime	7,930,252	14,913,229
Shuma inventar	175,934,127	144,648,712

Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike të kryera në fund të ushtrimit 2012. Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogaritë e rezultatit me mënyrën e inventarit të ndërmjetem. Si politike kontabel në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda "FIFO". Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabel 2012 është 590.805.112 lekë.

Drejtimi ka gjykuar se vlera e paraqitur është vlera me e ulët mes kostos së marrjes dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk ka nevojë për zhvlerësime të tij. Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2012 shoqëria ka zbatuar të njëjtat politika kontabile me ato të vitit paraardhës në lidhje me njohjen dhe vlerësimin e inventarëve.

7. Aktive afatgjata materiale

Aktivët Afatgjata Materiale (AAM-te) përbehen si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertime	Instalime teknike, makineri pajisje, etj.	Mjete transporti	Pajisje zyre e informatike	Totali
Kosto e AAM me 01.01.2012	0	6,274,464	82,022,876	35,596,951	1,853,712	125,748,002
Shtesat	0	0	(3,828,802)	2,222,880	951,877	(654,046)
Pakesimet	0	0	0	0	0	0
Kosto e AAM me 31.12.2012	0	6,274,464	78,194,074	37,819,831	2,805,588	125,093,957
Amortizimi AAM 01.01.2012		1,969,613	25,512,808	7,948,779	777,336	36,208,536
Amortizimi ushtrimor		86,097	2,492,221	552,963	269,094	3,400,376
Amortizimi për daljet AAM		0	0	0	0	0
Amortizimi i AAM me 31.12.2012	0	2,055,710	28,005,029	8,501,743	1,046,430	39,608,912
Vlera neto e AAM 31.12.2011	0	4,304,851	56,510,068	27,648,171	1,076,376	89,539,466
Vlera neto e AAM 31.12.2012	0	4,218,754	50,189,045	29,318,088	1,759,158	85,485,045

"BOMIRA" SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mesiperme janë të përputhura me të dhënat e inventarizimeve fizike që shoqëria ka kryer në fund të muajit dhjetor 2012. Drejtimi vlerëson se përgjithësisht për këtë ushtrim kontabel, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë njëta me ato që përdoren për qëllime fiskale. (shih shënimin nr.2). Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijtë e njohur për efekte fiskale.

8. **Detyrimet afatshkurtera-Huate dhe Parapagimet**

Huate dhe parapagimet përbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Te pagueshme ndaj furnitoreve		
Furnitore për mallra, produkte e shërbime	57,243,912	36,435,036
Te pagueshme ndaj punonjësve	0	
Detyrime tatimore	0	
Detyrime për sigurime shoqërore shëndetësore	272,304	268,110
Shteti për tatime e taksa	0	
Akciza	0	1,393,532
Tatim mbi të ardhurat personale	53,600	55,722
Tatim mbi fitimin	0	0
Tvsh për tu paguar	0	226,784
Te tjera tatime për tu paguar	1,611,858	0
Tatim në burim	0	0
Shuma Shteti për tatime e taksa	1,665,458	1,676,038
Shuma Detyrime Tatimore	1,937,762	1,944,148
Hua të tjera	0	
Debitore të tjera kreditore të tjera	0	7,912,431
Dividende për tu paguar	0	0
Shuma hua të tjera	0	7,912,431
Parapagimet e arketuara	0	25,646,612
Shuma Huatë dhe Parapagimet	59,181,675	71,938,228

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyrojnë detyrimet ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka përgatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogaritur sintetike është e barabartë me shumën e llogaritur analitike të mbajtura për çdo furnitor. Drejtimi vlerëson se të drejtat e furnitorëve janë të vlerësuar realisht.

"Detyrimet për sigurime shoqërore e shëndetësore" përfaqësojnë detyrimin për sigurimet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor 2012.

"Shteti për tatim taksa" pasqyrojnë detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale të muajit Dhjetor 2012.

"BOMIRA" SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

9. Kapitalet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqërise perbehet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Kapitali i paguar	212,873,000	176,603,000
Kapitali i nenshkruar i papaguar		
Shuma Kapitali themeltar	212,873,000	176,603,000

Kapitali i regjistruar i shoqërise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqërise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me vendim te Ortakut te Vetem u be zmadhimi i kapitalit themeltar ne shumen 36.270.000 leke nepermjet kalimit te fitimit ushtrimor dhe fitimeve te mbartura. Me 31.12.2012 kapitali i regjistruar i shoqërise eshte 212.873.000 leke, i ndare ne 212.873 kuota me vlere nominale 1.000 leke/kuote.

10. Fitimi(humbja) e vitit financiar

10.1 *Shitjet neto*

Shitjet neto perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Shitje e produkteve te gateshme	62,334,328	58,844,444
Shitja e punimeve dhe e sherbimeve	-	-
Shitje mallrash	634,001,349	713,843,531
Shuma Shitje neto	696,335,678	772,687,975

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.

10.2 *Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit*

Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit perbehen si vijon

"BOMIRA" SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2012 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

12. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytëzimit

Asnje ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit të pasqyrave financiare. Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare të shoqërisë, rezultojnë se në ushtrimin 2012 shoqëria ka stabilitet dhe zhvillim normal të biznesit. Drejtimi vlerëson se nuk ka rreziqe të ndërprerjes së veprimtarisë së saj për vitin në vazhdim.

13. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese të deklaruara në pasqyrat financiare 2011 janë të njëjta me ato të prezantuara në vitin aktual 2012.

KONTABEL I MIRATUAR

ARQILE DUKA



**PER DREJTIMIN E "BOMIRA" SH.P.K
ADMINISTRATORI**

YLLI ALIAJ


"BOMIRA" Shpk
Import Export
BERAT ALBANIA